



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.26, datë 09.07.2024

PËR
MIRATIMIN E LEJES PËR MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË KUSHTEVE TË LEJES
GJATË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “RESORT TURISTIK 2, 3 DHE
4 KATE MBI TOKË ME 1, 2 DHE 3 KATE NËNTOKË”,
ME VENDNDODHJE NË BASHKINË SARANDË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të subjektit zhvillues “Manastiri Resort” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e rishikimit të kushteve të lejes gjatë ndërtimit për objektin: “Resort Turistik 2, 3 dhe 4 kate mbi tokë me 1, 2 dhe 3 kate nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Sarandë, me subjekt zhvillues “Manastiri Resort” sh.p.k, miratuar me Vendimin Nr. 09, datë 10.06.2021 të Këshillit Kombëtar të Territorit.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave miratuar me Vendimin Nr. 09, datë 10.06.2021 të Këshillit Kombëtar të Territorit zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij Vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit

KRYETARI

EDI RAMA

KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRAT

KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
MIRELA KUMBARO FURXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 05/12/2024